



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 165 Akti

Nr. 167 Vendimi

Tiranë, më 21.6.2019

### V E N D I M

Trupi gjykues nr. 4 i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Kryesuese
<b>Lulzim Hamitaj</b>	Anëtar
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Fiorela Mandro, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma, në datën 20.6.2019, ora 9:00, zhvilloi në Pallatin e Kongreseve, seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Saida Dollani**, gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda, e pranishme në seancën dëgjimore.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet “A”, “Ç”, “D”, “DH”, “E” dhe “Ë” të Aneksit të Kushtetutës;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

### TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, dëgjoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:**

## **RRETHANAT E ÇËSHTJES**

1. Znj. Saida Dollani është subjekt i rivlerësimit për shkak të pozicionit të saj si gjyqtare në Gjykatën e Apelit për Krimet e Rënda. Bazuar në nenin 4, pika 4, dhe në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, si dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, në vijim, ka hedhur shortin në datën 15.1.2019, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 4.
2. Me vendimin e trupit gjykues, datë 24.5.2018, është vendosur kryesuese znj. Genta Tafa (Bungo), dhe është deklaruar lidhur me konfliktin e interesit nga të gjithë anëtarët e trupit gjykues.
3. Është njoftuar subjekti i rivlerësimit për përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e rivlerësimit, e cila ka deklaruar se nuk ka konflikt interesi me pjesëtarët e trupit gjykues.
4. Nga relatori janë administruar raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor. Gjatë procesit të rivlerësimit është komunikuar me subjektin e rivlerësimit nëpërmjet adresës elektronike.
5. Në datën 3.6.2019 trupi gjykues vendosi: (i) të përfundojë hetimin kryesisht për subjektin e rivlerësimit, znj. Saida Dollani, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit: kriterin e vlerësimit të pasurisë, kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit, ta ftojë për t’u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t’i ushtrojë këto të drejta dhe të paraqesë parashtrimet e saj.
6. Subjekti i rivlerësimit u njoh me dosjen dhe mori një kopje të saj, fakt të cilin e konfirmoi edhe në seancën dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit.
7. Në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues ftoi subjektin e rivlerësimit, znj. Saida Dollani në seancë dëgjimore, datë 20.6.2019, ora 9:00, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë.

## **SEANCA DËGJIMORE**

8. Seanca dëgjimore u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 20.6.2019, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.
9. Në këtë seancë subjekti i rivlerësimit u paraqit vetë. Ajo paraqiti shpjegime lidhur me rezultatet e hetimit. Në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit kërkoi konfirmimin në detyrë.
10. Trupi gjykues përfundoi seancën dëgjimore dhe për rrjedhojë edhe procesin e rivlerësimit për znj. Saida Dollani në seancën e datës 21.6.2019, në të cilën subjekti ishte prezent.

## **PROCESI I RIVLERËSIMIT I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

11. Procesi i rivlerësimit, i cili kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues që mbështetet në nenin 179/b dhe Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Anëtarët e Komisionit *hetojnë dhe vlerësojnë të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit*. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indice në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes.

12. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë:

- a) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga ILDKPKI-ja dhe provat e dorëzuara nga vetë subjekti pranë këtij institucioni në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, ‘Vetting’”;
- b) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja, së bashku me dokumentacionin shoqërues;
- c) Informacion të përditësuar lidhur me subjektin e rivlerësimit, nga institucionet ligjzbatuese;
- c) Raportin e dorëzuar pranë Komisionit nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, së bashku me materialin shoqërues;
- ç) Dokumente shpresore nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016;
- d) Deklarimet nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet komunikimit elektronik;
- dh) Shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit të paraqitura në përfundim të hetimit kryesisht;
- d) Denoncimet nga publiku.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

13. Subjekti i deklaramentit ka dorëzuar deklaratën e pasurisë për procesin e rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, së bashku me dokumentacionin provues. Kjo deklaratë, në bazë të nenit 33<sup>1</sup> të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, iu nënshtrua hetimit administrativ nga ILDKPKI-ja.

14. Në përfundim të hetimit administrativ, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “a” të ligjit nr. 86/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja në raportin e saj ka konkluduar se:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- d) *nuk ka kryer deklarament të rremë;*
- e) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

15. Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.<sup>2</sup>

---

<sup>1</sup>*“Procedura e vlerësimit të pasurisë 1. ILDKPKI-ja, bazuar në deklaramentet e pasurive, zhvillon një procedurë të plotë kontrolli në përputhje me ligjin, “Për deklaramentimin dhe kontrollin e pasurive, detyrimeve financiare të personave të zgjedhur dhe nëpunësve të caktuar publikë”, ligjin “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” si dhe “Kodin e Procedurave Administrative”.*

<sup>2</sup>Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit, është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjektevriklësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni i Pavarur i Kualifikimit gjatë këtij procesi.”

16. Deklarata e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, znj. Saida Dollani, iu nënshtrua një hetimi administrativ të thelluar, i cili konsistonte në verifikimin e vërtetësisë dhe saktësisë së deklaramëve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me gjendjen pasurore, burimet e krijimit, të ardhurat, shpenzimet, nëse ka konflikt interesi, fshehje të pasurisë apo deklarim të rremë, si dhe përcaktimin e gjendjes së fakteve dhe rrethanave që kanë lidhje me çështjen.

17. Në përfundim të hetimit administrativ, kur Komisioni krijoi bindjen se provat kanë nivelin e provueshmërisë, vendosi të mbyllë hetimin kryesisht, t'i japë të drejtë subjektit të njihet me rezultatet e këtij hetimi, si dhe me të gjithë dokumentacionin e administruar në dosje.

18. Subjekti i rivlerësimit, znj. Saida Dollani, në deklaratën e saj të pasurisë për procesin e rivlerësimit, por edhe pas verifikimit administrativ të kryer nga ILDKPKI-ja dhe nga Komisioni, rezulton se ka në pronësi pasuritë si më poshtë vijon:

19. **Apartament banimi** me sipërfaqe 79 m<sup>2</sup>, me adresë: Rr. “\*\*\*\*”, kulla nr. \*\*\*, kati \*\*\*, apartamenti \*\*\* (ose \*\*\*\*), Njësia Bashkiake nr. \*\*\*, Tiranë, përfituar nëpërmjet dhurimit, rivlerësuar në momentin e kalimit të pronësisë në vlerën 6.320.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.

20. Në datën 30.7.2009 subjekti e ka përfituar pasurinë nëpërmjet kontratës së dhurimit nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., nga motra e saj, znj. E. K., dhe bashkëshorti z. A. V. K. Kontrata e dhurimit është realizuar nga shtetasi A. K., përfaqësuar më prokurë të posaçme të lëshuar në \*\*\* SHBA, më 14.7.2009, (dokumenti i paraqitur me vulë APOSTILE) nga bashkëshortja e tij (motra e subjektit të rivlerësimit), po ashtu banues në \*\*\* SHBA, e cila gjithashtu ka dhënë pëlqimin e saj.

21. Nga verifikimi në sistemin TIMS ka rezultuar se znj. E. K., ka qenë në Shqipëri në momentin e lidhjes së kontratës së dhurimit.

22. Subjekti i rivlerësimit ka regjistruar pasurinë në ZVRPP-në Tiranë, mbi bazën e kontratës së dhurimit, në regjistrin hipotekor nr. \*\*\*, datë 29.8.2009. Në momentin e kalimit të pronësisë ZVRPP-ja ka vlerësuar këtë pasuri në shumën 6.320.000 lekë, dhe subjekti ka paguar detyrimet e kalimit të pronësisë në shumën 361.705 lekë (shpenzim i përfshirë në analizën financiare për vitin 2009).

23. Kjo pasuri është porositur nga kunati i subjektit z. A. V. K., në datën 6.5.2000, sipas kontratës së sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., të lidhur me shoqërinë “\*\*\*\*”. Me kontratën e shitblerjes së pasurisë të paluajtshme nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., në datën 28.12.2000 shoqëria “\*\*\*\*” i ka shitur apartamentin e banimit z. A. K. Pasuria është regjistruar në regjistrin hipotekor me nr. \*\*\*, datë 14.2.2001, në pronësi të z. A. V. K.

24. Sipas kontratës së sipërmarrjes të lartpërmendur, është përcaktuar çmimi i kësaj pasurie në vlerën 19.000 dollarë, çmim i cili rezulton të jetë shlyer plotësisht. Nga subjekti janë paraqitur pranë ILDKPKI-së kontrata e sipërmarrjes e datës 6.5.2000, si dhe mandatpagesat e kryera nga shtetasi A. K.

25. Komisioni ka vlerësuar të pyesë subjektin lidhur me krijimin e kësaj pasurie nga shtetasi A. K., edhe pse duket se kjo pasuri është fituar para se subjekti ka filluar të ushtrojë funksionin si gjyqtare. Subjekti ka deklaruar se z. A. K., është bashkëshorti i motrës (martuar në nëntor të vitit 1994). *Burimi për krijimin e kësaj pasurie janë të ardhurat nga pagat e bashkëshortëve K., dhe një hua në shumën 1.000.000 lekë, marrë nga shtetasja F. B., në datën 3.5.2000.* Subjekti ka bashkëlidhur një kopje të deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 19.5.2000, lidhur me këtë hua si dhe vërtetime të pagave përkatëse.

26. Komisioni administroi dokumentacionin “vërtetime të pagave ndër vite për periudhën 1994 – 2000”, për shtetasit A., dhe E. K., me qëllim për të vlerësuar aftësinë paguese që kanë pasur bashkëshortët me të ardhurat nga paga për blerjen e apartamentit. Nga përllogaritja e të

ardhurave për periudhën 1994 – 2000, rezulton se bashkëshortët K., kanë pasur të ardhura për të përballuar blerjen e kësaj pasurie.

Ata janë larguar në SHBA në dhjetor të vitit 2000 dhe aktualisht jetojnë atje. Lidhur me motivin e dhurimit të shtëpisë, subjekti ka shpjeguar se dhurimi ka qenë altruizmi i motrës dhe bashkëshortit të saj për kalimin në pronësi të apartamentit, të cilin që më parë ia kishin lënë në përdorim subjektit. Subjekti ka deklaruar se ***në momentin e dhurimit, të ardhurat e motrës dhe bashkëshortit në SHBA kanë qenë të larta referuar dhe gjendjes ekonomike të subjektit.***

27. Në përfundim të hetimit Komisioni konstaton se nuk ka dyshime mbi këtë pasuri të subjektit. Nga hetimi ajo rezultoi në përputhje me deklaratimet e subjektit.

**28. Llogari rrjedhëse në euro** në “Bankën Tregtare Kombëtare” (BKT), në vlerën 45.05 euro, e çelur më 3 shkurt të vitit 2014. Pjesa takuese: 100 %. *Burimi i krijimit:* Të ardhurat e subjektit nga paga si gjyqtare.

29. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin<sup>3</sup> e ardhur nga “Banka Kombëtare Tregtare”.

**30. Gjendje cash<sup>4</sup>**, në shumën 5.000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. *Burimi i krijimit:* shumë e tërhequr nga llogaria e pagës në lekë në “Raiffeisen Bank”, të çelur nga Gjykata e Apelit për Krime të Rënda, në vitin 2005.

31. Nga analiza financiare rezultoi se subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme për të krijuar gjendjen cash të deklaruar.

**32. Overdraft në limitin 150.000 lekë** në “Raiffeisen Bank”, detyrim i lindur brenda vitit 2016. *Burimi i krijimit:* Të ardhurat nga paga si gjyqtare. Deri në datën e deklaratimit “Vetting”, detyrimi i pashlyer i subjektit është në shumën - 90.596,52 lekë.

Nga hetimi rezultoi se ky overdraft lidhet me llogarinë rrjedhëse në lekë të subjektit në “Raiffeisen Bank”, në të cilën ajo përfiton të ardhurat nga paga si gjyqtare që nga viti 2005.

33. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

**34. Kredi konsumatore** në shumën totale 300.000 lekë, me interes 7.9 %. Kjo kredi është marrë nga “Raiffeisen Bank” sipas Kontratës së Kredisë Bankare datë 24.12.2015, për një afat trevjeçar. Deri në datën e deklaratimit në “Vetting”, detyrimi i pashlyer i subjektit është në shumën 207.975,05 lekë.

Vlera e kësaj kredie dhe detyrimet e paguara në lidhje me të janë përfshirë në analizën financiare për periudhën 2015 – 2016, si dhe për periudhën 2017 – 2018.

35. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

**36. Llogari në euro** e lidhur me *Master Card* në “Raiffeisen Bank”, me kushte: limit kreditimi deri në 700 euro, me normë interesi 16 %, përdorur nga djali i subjektit R. P., për pagesa të ndryshme në Francë, sipas prokurës me nr. \*\*\* rep., \*\*\* kol., datë 10.9.2015.

*Burimi i krijimit:* Të ardhura nga karta e kreditit. Deri në datën e deklaratimit në “Vetting”, detyrimi i pashlyer i subjektit është në shumën 208.32 euro.

37. Përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e ardhur nga “Raiffeisen Bank”.

<sup>3</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2018, “Banka Kombëtare Tregtare”.

<sup>4</sup> Tërhequr nga llogaria e subjektit në monedhën lekë në “Raiffeisen Bank”.

## PERSONAT E LIDHUR

38. Lidhur me dy djemtë e subjektit R., dhe H. P., të cilët jetojnë në Francë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore shpenzime arsimimi dhe jetese, të cilat do të trajtohen më poshtë.

### A. *Djali i subjektit R. P.*

39. Djali i subjektit, R. P., në vitin 2012 ka përfunduar studimet në shkollën e mesme publike “\*\*\*\*”, Tiranë dhe në shtator të vitit 2012, ka nisur studimet në institucionin publik, Universitetin \*\*\*, në Francë.

Në shtator të vitit 2013 deri në vitin 2016, ka studiuar në Universiteti \*\*\*, Francë, Fakulteti i Drejtësisë, me tarifë vjetore 400 euro. Në vitin 2016 ka vazhduar studimet në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti \*\*\*, Francë, të cilat ka vijuar t’i ndjekë edhe për vitet 2017 – 2018, me tarifë vjetore 400 euro.

40. Gjatë hetimit janë evidentuar këto shpenzime: shpenzime për studimin në universitet publik dhe jetesën në Francë, shpenzime për tarifë universitare, shpenzime banimi në kampusin universitar \*\*\*, shpenzime jetese, (deri në muajin gusht të vitit 2016 kur është transferuar në \*\*\*, Francë dhe jeton në të njëjtin apartament, me vëllain H. P., me shpenzime të përbashkëta jetese), të cilat paraqiten në formë tabelare më poshtë:

Shpenzime shkollimi / jetese në Francë - R. P.	2012	2013	2014	2015	2016
Pagesë për tarifë universitare, sig. shoq.	1 825 €	399 €	402 €	404 €	404 €
Pagese qiraje - ***	560 €	1 436 €	1 639 €	1 565 €	1 043 €
Shpenzime për jetesën	640 €	1 464 €	2 161 €	3 656 €	3 179 €
Total ne Euro	3 025 €	3 299 €	4 202 €	5 624 €	4 626 €
Total ne Lekë	422 653 Lekë	462 567 Lekë	588 756 Lekë	774 157 Lekë	625 773 Lekë

41. Këto shpenzime janë përballuar nga: (1) të ardhurat nga paga e subjektit, si dhe (2) financime në formë dhurimi nga babai i subjektit, z. L. D.

42. (1) *Të ardhurat nga paga e subjektit.* Gjatë hetimit administrativ është vënë re se subjekti ka kryer tërheqje periodike nga llogaria e saj e pagës në lekë në “Raiffeisen Bank”. Është vënë re se në “Raiffeisen Bank” është hapur një llogari “Master Card”, për përdorimin e të cilës është lëshuar një prokurë në emër të të birit për kryerjen e shpenzimeve në Francë (trajtuar më lart).

43. Gjithashtu, është evidentuar se subjekti ka kryer derdhje periodike tek llogaria e saj në euro në “BKT”, nga e cila ka transferuar vlera monetare në llogarinë bankare të të birit, pranë bankës “BNP Paribas”, Francë.

44. Vlera e derdhjeve të kryera nga subjekti për të birin në periudhën 2012 – 2016 është si vijon:

Transferata Saida Dollani	2012	2013	2014	2015	2016
Derdhje tek Master Card	1 315 €	3 483 €	4 308 €	3 450 €	5 018 €
Transferata R. P., nga “BKT”	- €	- €	- €	1 130 €	500 €
<b>TOTALI në EURO</b>	<b>1 315 €</b>	<b>3 483 €</b>	<b>4 308 €</b>	<b>4 580 €</b>	<b>5 518 €</b>
TOTALI në lekë	183 732 Lekë	488 351 Lekë	603 524 Lekë	630 469 Lekë	746 420 Lekë

**45. Rezulton se të ardhurat nga paga e subjektit janë të mjaftueshme për të kryer këto transferta.**

46. (2) *Dhurime nga babai i subjektit L. D.*, të cilat janë kryer nëpërmjet transfertave bankare nga llogaria e tij në euro në “BKT”, sipas tabelës së mëposhtme:

Transferta L. D., për R. P.,	2012	2013	2014	2015	2016
Transferta R. P., nga “BKT”	1 600 €	0	0	600 €	300 €
Vlera në lekë	223 552 Lekë	- Lekë	- Lekë	82 590 Lekë	40 581 lekë

Shënim: Analiza e mundësive financiare të L. D., do të trajtohet më poshtë në një seksion të veçantë, për arsye se ai ka financuar shpenzimet përkatëse për të dy djemtë e subjektit.

**Pasuritë e deklaruar nga djali i subjektit.**

**47. Llogari rrjedhëse** në bankën “BNP Paribas” në Francë, çelur më 16 dhjetor 2014 IBAN FR\*\*\*. Vlera: 27,04 euro Pjesa takuese: 100 %. *Burimi i krijimit:* Personi i lidhur ka deklaruar në të dhënat konfidenciale si burim krijimi: “*të ardhurat e familjarëve të mi të tërhequra/marrë nga karta e kreditit (Master Card), në emër të nënës sime, Saida Dollani, kartë që e kam në posedim dhe përdorim me prokurë të posaçme.*”

48. Nga verifikimi rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.

**49. Llogari bankare në “La Banque Postale” \*\*\***, Francë, e çelur në vitin 2012 dhe e mbyllur në vitin 2014, deklaruar në deklaratat periodike vjetore 2012, 2013 dhe 2014. *Burimi i krijimit:* të ardhurat e familjarëve.

Gjatë hetimit<sup>5</sup> ka rezultuar se R. P., ka pasur llogari pranë kësaj banke me nr. klienti \*\*\*BGP, të lidhur me 5 produkte bankare, e cila aktualisht rezulton e mbyllur.

50. Nga verifikimi rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.

**B. Djali i subjektit H. P.**

51. Djali tjetër i subjektit H. P., në vitin 2012 ka përfunduar studimet në shkollën e mesme publike “\*\*\*”, Tiranë. Në shtator të vitit 2013 ka nisur studimet në Universitetin \*\*\*<sup>6</sup>, Francë, në Fakultetin e Shkencave dhe Inxhinierisë, të cilat ka vijuar t’i ndjekë edhe për vitin 2018 – 2019, me tarifë vjetore 400 euro.

52. Gjatë hetimit janë evidentuar këto shpenzime: shpenzime për studimin në universitetin publik dhe jetesën në Francë, shpenzime për tarifë universitare, shpenzime banimi në apartament<sup>6</sup> me qira, shpenzime jetese, të cilat paraqiten në tabelën si më poshtë:

Shpenzime shkollimi dhe jetese në Francë - H. P.	2012	2013	2014	2015	2016
Pagesë për tarifë universitare, sig. shoqërore dhe sporte.	- €	414 €	432 €	419 €	419 €
Pagese qiraje apartamenti	- €	1 040 €	3 120 €	3 120 €	3 620 €
Shpenzime për jetesën	- €	1 573 €	3 215 €	3 955 €	4 182 €
TOTAL në Euro	- €	3 027 €	6 767 €	7 494 €	8 221 €
TOTAL në Lekë	Lekë	424 430 Lekë	948 138 Lekë	1 031 563 Lekë	1 112 068 Lekë

<sup>5</sup> Vërtetim bankar, dërguar nga subjekti me e-mail, datë 15.5.2019.

<sup>6</sup> Sipas kontratës së qirasë për periudhën 1.9.2013 – 31.8.2016, për apartamentin në adresën Rr. “\*\*\*”, nr. \*\*\*<sup>6</sup>, \*\*\* dhe kontratës së qirasë për periudhën 1.3.2016, për apartamentin në adresën “\*\*\*”.

53. Subjekti ka sqaruar<sup>7</sup> se, që nga muaji gusht i vitit 2016, të dy fëmijët e saj jetojnë në një apartament, të marrë me qira nga H. P., në \*\*\*, Francë dhe se shpenzimet e jetesës i kanë të përbashkëta.

54. Këto shpenzime janë përballuar nga: (1) të ardhurat nga paga e subjektit, (2) financime në formën e dhurimit nga babai i subjektit, z. L. D., (3) vëllai i subjektit, G. D., (4) ndihma financiare nga organizata sociale CAF, si dhe (5) të ardhurat nga punësimi i tij.

55. (1) *Të ardhurat nga paga e subjektit.* Gjatë hetimit administrativ është vënë re se subjekti ka kryer tërheqje periodike nga llogaria e saj e pagës në “Raiffeisen Bank”.

Është evidentuar se subjekti ka kryer derdhje periodike tek llogaria e saj në euro pranë “BKT”-së, nga e cila ka transferuar vlera monetare në llogarinë bankare të të birit, pranë “La Banque Postale”, Francë, si vijon:

Transferta Saïda Dollani për H. P.	2012	2013	2014	2015	2016
Transferta H. P., nga “BKT”	0	0	3 602 €	5 410 €	4 130 €
<b>Totali në lekë</b>	- Lekë	- Lekë	504 676 Lekë	744 687 Lekë	558 665 Lekë

56. Rezultoi se të ardhurat nga paga e subjektit janë të mjaftueshme për të përballuar transfertat.

57. (2) *Dhurime nga babai i subjektit L. D.,* të cilat janë kryer nëpërmjet transfertave bankare nga llogaria e tij në euro pranë “BKT”-së, sipas tabelës së mëposhtme:

Transferta L. D., për H. P.	2012	2013	2014	2015	2016
Transferta H. P. nga BKT	- €	1 300 €	1 650 €	1 240 €	800 €
<b>Totali në lekë</b>	- Lekë	182 273 Lekë	231 182 Lekë	170 686 Lekë	108 216 Lekë

### C. Babai i subjektit z. L. D.

58. Për shkak se babai i subjektit ka financuar studimet dhe shpenzimet e shkollimit për dy fëmijët e saj në periudhën 2012 – 2017, sikurse është përmendur më lart, nga Komisioni u krye një hetim në drejtim të mundësive financiare të z. L. D.

59. Nga shqyrtimi i llogarive bankare rezultoi se babai i subjektit ka pasur likuiditete në formën e depozitave dhe llogarive rrjedhëse, nga viti 2004 deri në vitin 2011 (me vlera që variojnë nga 1.000.000 deri në 2.000.000 lekë). Megjithatë dhurimet për shkollimin e fëmijëve të subjektit fillojnë në vitin 2012, Komisioni ka pyetur subjektin në lidhje me burimin e krijimit të llogarive të kursimit.

60. Subjekti deklaron<sup>8</sup> se bazuar në deklaratimet e të atit “*depozitat bankare nga viti 2004 – 2011, kanë pasur si burim të ardhurat nga shitja e pasurisë së nënës time (të fituar me trashëgimi), të ardhurat nga qiraja me shoqërinë “\*\*\*”, të ardhurat nga suporti financiar i vëllait G. D., dhe motrës E. K., si dhe, të ardhurat nga qiraja e objektit në bashkëpronësi, e cila për një periudhë kohe (me miratimin e bashkëpronarëve) është akumuluar në llogarinë bankare në emër të babait tim, me qëllim për rregullimet dhe mirëmbajtjen e objektit në bashkëpronësi.*”

61. Nga llogaritë rrjedhëse të L. D., është konstatuar se subjekti ka përfituar qira në mënyrë periodike si dhe ka paguar tatim në burim në “Procredit Bank”<sup>9</sup>, dega Berat.

<sup>7</sup> Pyetësori nr. 1,

<sup>8</sup> E-mail, datë 15.5.2012, pika 3.

<sup>9</sup> Shkresa nr. \*\*\*, prot., datë 15.11.2018.



62. DRT Berat, informon<sup>10</sup> se në periudhën 2012 – 2014, L. D., ka paguar tatim në burim, në shumën totale prej 288.000 lekësh. DRT-së Berat i është rikërkuar informacion lidhur me dokumentacionin mbështetës për këto qira, e cila me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2019, konfirmon se në periudhën 2008 – 2014 është paguar shuma totale prej 470.300 lekësh nga NIPTI J\*\*\*<sup>11</sup> për tatimin në burim për shtetasin L. G. D.

63. Bazuar në këtë konstatim, është pyetur edhe subjekti në lidhje me qiratë e tjera të përfituara nga babai i saj, i cili sqaron<sup>12</sup> se: *“pagimi i tatimit në burim për qira për periudhën 2001 – 2014 i përket dhënies me qira të pasurisë në bashkëpronësi me nr. \*\*\*, Berat, e fituar me trashëgimi, e cila administrohet me marrëveshjen e të gjithë bashkëpronarëve nga L. D., i cili zotëron 1/7 e 1/3 pjesë. Shuma totale e përfitur nga babai im prej qirave në vite të kësaj pronësie është rreth 822.857 lekë”*.

64. Komisioni u kërkoi informacion Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme nga ku rezultoi se në ZVRPP-në Berat janë të regjistruara në pronësi të tij dy pasuri të paluajtshme:

- Pasuri me nr. \*\*\*, e llojit “truall dhe godinë 2-katëshe”, me sip. truall 183 m<sup>2</sup>, nga kjo, sip. ndërtimi 126 m<sup>2</sup>, e ndërtuar me leje ndërtimi me nr. \*\*\*prot., datë 10.5.1968 “për ndërtim shtëpie në lagjen “\*\*\*” nr. \*\*\*”, e regjistruar në vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k. \*\*\*, Berat, regjistruar në datën 11.06.2007.
- Pasuri me nr. \*\*\*, e llojit “truall dhe godinë njëkatëshe”, me sip. truall dhe ndërtimi \*\*\* m<sup>2</sup>, vol. \*\*\*, f. \*\*\*, z.k. \*\*\*<sup>13</sup>, Berat, e përfitur me vendim “kthim kompensim toke”, e ndodhur në lagjen “\*\*\*”, në pronësi të L. G. D., dhe 23 bashkëpronarë të tjerë<sup>14</sup>.

65. OSHEE identifikon dy abonentë me gjeneralitetet L. D., në instancën e Beratit, kontratë nr. BE\*\*\*, datë 5.5.2005 dhe kontratë BE\*\*\*, datë 30.3.2016.

66. Përputhen të dhënat e kontratave me OSHEE-në me adresat e pasurive në pronësi të L. D.

67. QKB-ja informon se z. L. D., ka qenë i regjistruar si person fizik në datën 20.4.2006 me NUIS \*\*\* me objekt aktiviteti: Bar Kafe në Rr. “\*\*\*”, Tiranë dhe është çregjistruar në vitin 2010.

68. Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) Tiranë<sup>15</sup>, konfirmon regjistrimin e subjektit pranë organeve tatimore. Komisioni i kërkoi informacion DPTTV-së, Bashkia Tiranë, në lidhje me xhiron e deklaruar për periudhën 2007 – 2010, e cila informon se nuk disponohen të dhëna mbi qarkullimin vjetor për periudhën 2007 – 2010.

69. Subjekti është pyetur në lidhje me burimet e ligjshme të financimeve të kryera nga babai i saj, e cila deklaron të ardhura (të ardhurat e prindërve të saj) në periudhën 2012 – 2017 për prindërit e saj L., dhe M. D., nga këto burime: pensionet e pleqërisë, qiratë, dëmshpërblimet financiare për ish të dënuarit politikë të regjimit komunist, suport financiar nga dy fëmijët e tyre, E. K., dhe G. D.

70. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentacion provues (vërtetim pensionesh, vërtetim për qiranë nga shoqëria “\*\*\*”<sup>16</sup>, ekstrakt të llogarisë bankare për dëmshpërblimet, kopje të pasaportave dhe lejeve të qëndrimit të përhershme në SHBA për L., dhe M. D).

<sup>10</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.4.2019.

<sup>11</sup> U verifikua në web-in e QKB-së, ku nuk figuron i regjistruar.

<sup>12</sup> E-mail, datë 15.5.2012, pika 2.

<sup>13</sup> Të dhënat e mësipërme i përkasin regjistrimit fillestar, sporadik të pasurive të paluajtshme të kësaj zone kadastrale, sipas informacionit të ZVRPP-së Berat, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.12.2018.

<sup>14</sup> Lista e bashkëpronarëve sipas dokumentacionit nga ZVRPP-ja Berat.

<sup>15</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2018.

<sup>16</sup> Pagesa të kryera pranë “Procredit Bank” dhe “BKT”.

71. Nisur nga të ardhurat e sipërcituara deklaruar nga subjekti, Komisioni përgatiti një tabelë përmbledhëse, ku pasqyrohen të ardhurat e prindërve të subjektit dhe totalin e dhurimeve të kryera nga L. D., kundrejt të dy nipërve **në periudhën 2012 – 2017**, si vijon:

<b>Të ardhura L. &amp; M. D.</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>2016</b>	<b>2017</b>
Pension pleqërie L. D.	231 432	239 404	246 504	256 407	272 875	301 426
Pension pleqërie M. D.	220 422	228 273	235 755	239 255	242 722	250 890
Të ardhura neto nga “****” sh.p.k.	120 000	120 000	120 000	120 000	120 000	120 000
Të ardhura neto nga qiraja <sup>17</sup>	41 143	44 571	37 714			
Të ardhura nga dëshmipërblimet Ministria e Financave <sup>18</sup>				43 745		
Transferta bankare nga G. D., në llogarinë “BKT” <sup>19</sup>				192 710		
<b>TOTALI</b>	<b>612 997</b>	<b>632 248</b>	<b>639 973</b>	<b>852 117</b>	<b>635 597</b>	<b>672 316</b>
<b>Transferta L. D., në Francë</b>	223 552	182 273	231 182	253 276	148 797	66 475

72. Subjekti deklaroi<sup>20</sup> se prindërit e saj që nga viti 2014 jetojnë në SHBA, të cilët bashkëjetojnë për periudha të shkurtra të vitit me motrën E. K., dhe bashkëshortin e saj. Njëkohësisht ata i mbështesin financiarisht prindërit. Subjekti deklaroi se edhe vëllai i saj, G. D., shtetas dhe rezident i Republikës Franceze, mbështet financiarisht prindërit.

73. Nga hetimi i kryer ka rezultuar se babai i subjektit ka pasur të ardhura financiare të mjaftueshme për të realizuar financimet e lartpërmendura për dy fëmijët e subjektit.

74. (3) *Dhurime nga vëllai i subjektit, G. D., në shumën prej 560 eurosh* për garancinë e apartamentit të marrë me qira në Francë nga i biri i subjektit, H. P., në vitin 2013, dhe 291.99 euro në vitin 2016, për pagesën e dy biletave të udhëtimit.

75. Subjekti ka deklaruar se i vëllai është shtetas dhe rezident i përhershëm në Republikën Franceze, si dhe ka paraqitur dokumentacion provues mbi të ardhurat e tij të ligjshme. Komisioni ka pasqyruar në tabelën e mëposhtme të ardhurat e vëllait të deklaruar nga subjekti.

<b>Viti</b>	<b>Të ardhura neto vjetore</b>	<b>Të ardhura neto mujore</b>
<b>2013</b>	23 954 €	1 996 €
<b>2014</b>	16 719 €	1 393 €
<b>2015</b>	21 782 €	1 815 €
<b>2016</b>	23 322 €	1 944 €
<b>2017</b>	26 868 €	2 239 €

76. Duket se vëllai i subjektit ka të ardhura të mjaftueshme nga burime të ligjshme, të cilat justifikojnë financimin e kryer.

77. (4) *Të ardhura nga CAF*, organizatë franceze e ndihmës financiare me natyrë sociale, akorduar si ndihmë për strehë/banesë për periudhën 2013 – 2016 (shumë e cila që nga muaji

<sup>17</sup> 1/7 pjesë e 1/3 së qirasë totale nga prona nr. \*\*\* z.k. \*\*\* në Berat, e-mail datë 15.9.2019. Ndarja në vite sipas shkresës nr. \*\*\* prot., datë 18.4.2019 nga DRT Berat.

<sup>18</sup> Dëshmipërblim MOF, shkresa nr. \*\*\* prot., datë 11.5.2015, derdhur në llogarinë bankare të L. D., në “Tirana Bank” (pjesa takuese: 1/7 pjesë e vlerës totale të derdhur në llogari).

<sup>19</sup> Kjo tabelë përfshin edhe dhurimet që G. D., ka kryer për të atin nëpërmjet transfertave bankare në llogarinë e tij në “BKT”.

<sup>20</sup> E-mail datë 2.5.2019 nga subjekti, pika 2.6

mars 2016 e në vazhdim derdhet drejtpërdrejt në llogarinë e \*\*\*, qiradhënëse e banesës ku jeton përkohësisht, për qëllime studimesh, në \*\*\*, Francë), sipas tabelës vijuese:

Të ardhura CAF për qiranë – H. P., (sipas vërtetimit nga subjekti)	VITI 2013	VITI 2014	VITI 2015	VITI 2016
<b>Totali në Euro</b>	273 €	1 085 €	1 105 €	1 104 €
<b>Totali në Lekë</b>	38 227 Lekë	151 987 Lekë	152 156 Lekë	149 338 Lekë

78. Konfirmohen këto të ardhura nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti.

79. (5) **Të ardhurat nga punësimi** në vitin 2016, në vlerën 2.186,84 euro (ose 295.814 lekë) deklaruar në deklaratën “Vetting”:

a) Të ardhura nga puna në \*\*\*Restaurant \*\*\*, vlera 1.063,78 euro.

→ Konfirmohen këto të ardhura nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti<sup>21</sup>.

b) Të ardhura nga puna si \*\*\*, vlera 1.037,61 euro.

→ Konfirmohen këto të ardhura nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti.

c) Të ardhura nga puna në \*\*\*, vlera 85.45 euro.

→ Konfirmohet këto të ardhura nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti<sup>22</sup>.

80. **Likuiditete në llogari rrjedhëse** në bankën “La Banque Postale”, Francë, më 9.9.2013, me vlerë 54 euro dhe IBAN FR\*\*\*. Pjesa takuese: 100 %. *Burim krijimi: “të ardhurat e familjarëve të mi, ndihma mujore për strehim akorduar nga CAF, si dhe për vitin 2016 edhe me të ardhurat nga puna ime”.*

81. Nga hetimi rezultoi se përputhet deklarimi i subjektit me dokumentacionin e paraqitur.

82. Subjekti ka deklaruar në DPV-në e vitit 2003 adresë banimi:, Në DPV-në e vitit 2004 e në vijim subjekti deklaroi adresën: Rr. “\*\*\*”, kulla nr. \*\*\*, Tiranë.

83. Nga verifikimi ka rezultuar se subjekti ka jetuar deri në vitin 2003 së bashku me bashkëshortin e saj, z. K. P., në banesën me adresë: Lagjja \*\*\*, Rr. “\*\*\*\*”, nr. \*\*\*, Durrës, (në të njëjtën banesë jetonin edhe prindërit e bashkëshortit). Në vitin 2004 e në vijim deklaroi adresën: Rr. “\*\*\*\*”, kulla nr. \*\*\*, Tiranë.

84. Nga informacioni i marrë nga ZVRPP-ja Durrës, nuk rezultoi e regjistruar pasuri në emër të subjektit dhe bashkëshortit të saj.

85. Është kërkuar informacion nga Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Ujësjellës Kanalizime, Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor Tiranë, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, ALUIZNI, Qendra Kombëtare e Biznesit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Ministria e Drejtësisë.

86. Nga hetimi nuk rezultuan të dhëna apo indice për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo personave të lidhur.

87. Në regjistrin e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare nuk rezultoi që subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të (bashkëshorti dhe fëmijët) të kenë pasur ndonjë automjet në pronësi ose në përdorim.

88. Komisioni përgatiti analizën financiare për periudhën 2003 – 2016, nga e cila rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar pasuritë, shpenzimet si dhe shtesën në kursime. Gjithashtu, edhe për aq sa vlerësohet

<sup>21</sup> Vërtetim dërguar me e-mail nga subjekti në datën 9.5.2019, në përgjigje të pyetjes 4, pyetësori datë 29.3.2019.

<sup>22</sup> Vërtetim në përgjigje të pyetjes 4, pyetësori datë 29.3.2019.

nga shqyrtimi i dokumentacionit, standardi i jetesës duket modest dhe në raport të drejtë me statusin social e financiar të subjektit dhe personave të lidhur.

89. Komisioni përgatiti analizën financiare për viteve 2017 dhe 2018, e cila rezultoi me një bilanc pozitiv dhe se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar shpenzimet dhe shtesën në kursime.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të pasurisë**

Nga hetimi rezultoi se bilanci financiar sipas këshillimit të Njesisë së Shërbimit Ligjor, është pozitiv dhe subjekti i rivlerësimit nuk ka probleme me pasurinë dhe analizën financiare ndër vite. Gjithashtu, edhe për aq sa vlerësohet nga shqyrtimi i dokumentacionit, standardi i jetesës duket modest dhe në raport të drejtë me statusin social e financiar.

Nga hetimi i kryer dhe vlerësimi i dokumenteve të administruara në dosje, trupi gjykues arriti në përfundimin se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

Subjekti është treguar bashkëpunues gjatë gjithë periudhës së hetimit kryesisht, duke iu përgjigjur pyetësorit të dërguar, si edhe pyetjeve shtesë në një kohë të shpejtë dhe duke dhënë në mënyrë të besueshme dhe shteruese informacionin e kërkuar.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

90. DSIK-ja, në përmbushje të ushtrimit të funksioneve sipas ligjit nr. 8457, datë 11.2.1999, i ndryshuar, pasi ka kryer të gjitha procedurat për kontrollin në përputhje me parashikimet e neneve 4, pika 4, 37 e 38, të ligjit nr. 84/2016, ka paraqitur pranë Komisionit raportin përfundimtar me nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht, ku rezulton se:

- Formulari i deklarimit është i plotë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës.
- Për subjektin e rivlerësimit nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, ose persona të dyshuar të krimin të organizuar.

91. *Në përfundim të raportit Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar ka konstatuar se subjekti i rivlerësimit, znj. Saida Dollani është e përshtatshme për vazhdimin e detyrës.*

92. Komisioni kërkoi nga institucionet ligjzbatuese përditësim të informacionit lidhur me subjektin e rivlerësimit.

93. Gjatë procesit të hetimit Komisioni nuk konstatoi asnjë problematikë lidhur me pastërinë e figurës për subjektin e rivlerësimit znj. Saida Dollani.

### **Konkluzione për rubrikën e vlerësimit të figurës**

*Trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar prej subjektit të rivlerësimit, deklaratën për kontrollin e figurës, raportin e DSIK-së, informacione nga organet ligjzbatuese, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklarimit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë dhe me vërtetësi. Nuk u provua që subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo që ajo të jetë e përfshirë, apo e vënë nën presion nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, si rrjedhojë e gjen atë të përshtatshme për vazhdimin e detyrës.*

Në përfundim, trupi gjykues vlerësoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Saida Dollani ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

### C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

94. Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ka dorëzuar raportin profesional.

95. Në analizë të përbashkët të dokumenteve të vlerësuara, konstatohet se subjekti i rivlerësimit mban të njëjtin stil në hartimin e vendimeve dhe organizimi strukturor i vendimeve paraqitet në nivel të mirë.

Ajo identifikon normën ligjore të zbatueshme dhe jep arsye për mënyrën e zbatimit të saj në rastin konkret. Gjyqtarja Saida Dollani ka aftësi shumë të mira në drejtim të interpretimit dhe zbatimit të ligjit, si dhe analizon normën ligjore materiale të zbatueshme në zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Ajo ndalet në shqyrtimin e shkaqeve të ankimit duke analizuar, si çështjet e së drejtës procedurale, edhe çështjet e së drejtës substanciale. Njeh parimet e përgjithshme të së drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe i zbaton ato në praktikë, si dhe i bën pjesë të vendimeve gjyqësore shprehimisht. Njeh dhe zbaton të drejtën ndërkombëtare, njeh dhe zbaton Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. Njeh dhe zbaton vendimet e Gjykatës Kushtetuese, njeh dhe zbaton vendimet unifikuese të Gjykatës së Lartë.

Gjyqtarja Saida Dollani ka njohuri shumë të mira të së drejtës penale, sidomos për ato vepra penale që përfshihen në kompetencën lëndore të gjykatave për krime të rënda. Bën lidhjen e pjesës së përgjithshme me atë të posaçme të Kodit Penal duke identifikuar rastin kur vepra penale është kryer në bashkëpunim, kur vepra penale nuk është përfunduar dhe ka mbetur në tentativë, si dhe njeh kriteret e individualizimit të masave të dënimit. Gjithashtu, ajo zotëron njohuri të rregullave procedurale të gjykimit civil për aq kohë sa ato janë të zbatueshme në gjykimin e çështjeve civile apo rregullat procedurale penale për gjykimin e masave të sigurimit.

96. Gjatë periudhës së rivlerësimit për gjyqtaren Saida Dollani **nuk rezulton asnjë ankesë në Inspektoratin e ish-KLD-së.**

97. Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Saida Dollani përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### Konkluzione për rubrikën e vlerësimit profesional

*Trupi gjykues vlerëson se, në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të mira në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, dhe konsiderohet “e aftë”.*

*Trupi gjykues arrin në përfundimin se, subjekti i rivlerësimit ka nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.*

### D. DENONCIMET E PUBLIKUT

98. Për subjektin e rivlerësimit, znj. Saida Dollani kanë ardhur pranë Komisionit gjashtë denoncime.

**1. Denoncimi i shtetasit V. Ç., me nr. \*\*\* prot., datë 15.2.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.3.2019,** i përsëritur, ndaj trupit gjykues, ku subjekti i rivlerësimit është anëtar. Denoncimi ka në objekt shkelje ligjore, të cilat janë formalizuar në një kallëzim penal ndaj trupit gjykues, drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda. Komisioni

administroi faktet e përmendura në kallëzim që lidheshin kryesisht me pakënaqësitë ndaj vendimeve të marra nga subjektet, për të cilët denoncuesi ka vënë në lëvizje edhe gjykatën kompetente për të kërkuar përjashtimin e tyre. Gjithashtu, pas verifikimit rezultoi se çështja është në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit Gjyrokastër.

Ky denoncim nuk përmban elementët e detyrueshëm që lidhen me përshkrimin e shkeljes ligjore, fakteve apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit, sipas nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

**2. Denoncim i shtetasit B. R. K., me nr. \*\*\* prot., datë 12.2.2018.** Ky denoncim iu referohet 24 subjekteve të rivlerësimit, me objekt trajtimi ankesa të ndryshme ndaj tyre. Ankimi drejtuar subjektit dhe disa subjekteve të tjerë nuk përmban elementët e domosdoshëm që lidhen me objektin e tij, përshkrimin e shkeljes ligjore dhe pasojat e ardhura, sipas nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

**3. Denoncim i shtetasit Sh. B. H., me nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018,** drejtuar pesë gjyqtarëve të Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda, ndërmjet të cilëve është edhe subjekti i rivlerësimit. Ky denoncim është i paqartë dhe nuk përmban elementët e domosdoshëm që lidhen me objektin e tij, përshkrimin e shkeljes ligjore dhe pasojat e ardhura, sipas nenit 53, pika 2, të ligjit nr. 84/2016.

**4. Denoncim i shtetasit A. H., me nr. \*\*\* prot., datë 6.11.2018** ndaj gjashtë subjekteve të rivlerësimit. Në këtë denoncim përfshihet edhe subjekti znj.Dollani, e cila është denoncuar për vendim të padrejtë të marrë në trupë, caktuar me vendim të Këshillit të Lartë të Drejtësisë nr. \*\*\*, datë 24.3.2017 pranë Gjykatës së Apelit Gjyrokastër, për shqyrtimin e çështjes penale nr. \*\*\* akti, me kërkues, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Përmet, me të pandehur K. S., akuzuar për veprën penale “Falsifikim i dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/2 i Kodit Penal. Nga faktet e trajtuara në këtë denoncim, nuk ka indice për nisjen e hetimit ndaj subjektit të rivlerësimit.

**5. Në datën 14.5.2019 në Komision është regjistruar denoncimi me nr. \*\*\* prot., ardhur nga nga E., B. Sh., G. D., dhe E. Z.,** drejtuar subjektit të rivlerësimit, me objekt “kryerja e shkeljeve ligjore me pasojë cenimin e procesit ligjor dhe garancitë për paanshmëritë e tij”.

Çështja është në shqyrtim pranë Gjykatës së Apelit për Krimet e Rënda. Komisioni vlerëson se bazuar në Aneksin e Kushtetutës, neni E, pika 2, vlerësimi i aftësisë profesionale nuk shtrihet ndaj çështjeve që janë në shqyrtim.

99. Gjatë procesit të rivlerësimit, Komisioni është vënë në dijeni mbi disa fakte të bëra publike në media se subjekti i rivlerësimit është kërcënuar me jetë për shkak të një procesi gjyqësor që po zhvillohet pranë Gjykatës së Krimeve të Rënda. Në vlerësim të këtyre fakteve, Komisioni ka pyetur subjektin lidhur më vërtetësinë e tyre. Subjekti është përgjigjur brenda një kohe shumë të shkurtër duke sqaruar lidhur me to.

Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se ka kallëzuar në Prokurori edhe portalin *online* “\*\*\*”, i cili në datën 14 maj 2019 ka publikuar shkrimin me titull “Gjyqtarja Dollani me krimin “nën çati” sajon alibinë e “kërcënimit me jetë”, për të shpëtuar nga fshesa e “Vetting-ut””, i cili ka përdorur, hapur në ndërthurje të interesave private me çështjet që janë në gjykim shtypin *online* duke kërcënuar me dhunë psikike subjektin për ta penguar në kryerjen e detyrës. Mbi bazën e këtij kallëzim kanë filluar hetimet pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti ka bashkëlidhur vërtetimet përkatëse, lëshuar nga Prokuroria e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

100. Pas vlerësimit të fakteve dhe dokumentacionit mbi denoncimet nuk u vërejtën rrethana për fakte që krijojnë bindjen se ka pasur shkelje ligjore, apo të dhëna e indicje për subjektin e rivlerësimit, për të vijuar me hetime të mëtejshme.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 58, pika 1, germa “a”, dhe 59, pika 1, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pasi konstatoi se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, një nivel të besueshëm të kontrollit të figurës, si dhe një nivel të mirë të vlerësimit të aftësive profesionale,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Saida Dollani.
2. Ky vendim i arsyetuar, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 21.6.2019

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

### **KRYESUES**

Genta Tafa (Bungo)  
nënshkrimi

### **ANËTAR**

Lulzim Hamitaj  
nënshkrimi

### **RELATOR**

Valbona Sanxhaktari  
nënshkrimi

*Sekretare gjyqësore*

Fiorela Mandro  
nënshkrimi